

## RAPORT

### MBI PËRDORIMIN E FONDEVE REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT GJATË PERIUDHËS 1 JANAR-31 DHJETOR, 2022

#### **I. Fondi Rezervë**

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

**1. Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,** miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën **2.9 miliardë lekë**, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:

- a) 2 400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
- b) 500 milionë lekë për projektin për fëmijët dhe rininë.

**2. Me AN nr.3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,** Fondi Rezerve ndryshoi në masën **2.650 miliard lekë**, ndërkohë që Neni 5, përcakton përdorimin e tij :

- a) *Fondi rezervë prej 2 650 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;*

**3. Me AN nr.12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,** të ndryshuar, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 3 350 milionë lekësh, ndërkohë që Neni 7, përcakton përdorimin e tij:

- a) *Fondi rezervë i buxhetit prej 3 350 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme.*

**4. Me AN nr. 17, datë 1.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,** të ndryshuar, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 3 500 milionë lekësh.

**5. Me AN nr. 19, datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,** të ndryshuar, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 10 620 milionë lekësh ndërkohë që Neni 3, përcakton përdorimin e tij:

- a) Ne masen 2 820 milionë lekësh me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
- b) Ne masen 7 800 milionë lekësh me vendim të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën.

**Fondi Rezerve i buxhetit të Shtetit i planifikuar prej 10 620 milionë lekësh, deri më datë 31.12.2022, është përdorur në masën 10 545 milionë lekë, ose 99.3% e planit dhe konkretisht:**

- Deri në datën 31.12.2022, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave(VKM)me vlerë totale prej 2 808.9 milionë lekësh, nga 2.82miliard lekë të planifikuara ose në rreth 99.6% përqind të planit.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë deri më 31.12.2022 (në milionë lekë)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2022	Miratuar me ligj për vitin 2022	Përdorur me VKMderi 31.12. 2022	Mbetur pa përdorur me 31.12.2022	Përqindja (Përdorur/Planifikuar)
	2 820	2 808.9	11.1	99.6


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Më konkretisht, nga përdorimi deri më 31.12.2022, prej 2 808.9 milionë lekë, rezulton se:

- Rreth 53.1milion lekë ose 2 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime personeli.
- Rreth 2 755.8 milionë lekë ose 97.7përqind e planit (shpenzime operative dhe transferta të brendshme e të jashtme);

Grafiku i mëposhtëm paraqet përkatësisht, strukturën e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, deri më 31.12.2022:

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, deri më 31.12.2022 (në mijë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Ndërsa përdorimi i Fondit Rezervë sipas ministrive dhe institucioneve qendrore paraqiten në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë).

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në % ndaj totalit
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10	755 262	26.9%
12	Ministria e Kulturës	1	700 000	24.9%
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	190 000	6.8%
11	Ministria Arsimit dhe Sportit	4	500 710	17.8%
13	Ministria Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	1	399 000	14.2%
15	Ministria e Punëve të Jashtme	1	116 760	4.2%
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	65 000	2.3%
87	Institucione të tjera Qeveritare	2	69 700	2.5%
16	Ministria e Brendshme	1	7 200	0.3%
50	Instituti i Statistikave	1	5 300	0.4%
<b>TOTALI</b>			<b>2 808 932</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)*

Në mënyrë analitike rezulton se:

- ✓ 755.2 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet dhjetë VKM-ve si më poshtë:
  - 1.3 milionë leke me VKM-në nr. 29, datë 19.01.2022 “Për ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dt 12.01.2021, për çështjen "Budo kundër Shqipërisë”.
  - 1.3 milionë lekë me VKM-në nr. 290, datë 11.05.2022 “Për ekzekutimin e VGJEDNJ për çështjen Laçi kundër Shqipërisë.
  - 1.87 milionë lekë me VKM nr. 369, datë 1.06.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 9.12.2021, për çështjen “Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë.”
  - 300 milionë lekë me VKM nr. 375, datë 1.06.2022 “Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për MFE, nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit për zbatimin e Ligjit nr.25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-upeve".
  - 1.6 milionë lekë me VKM nr. 566, datë 7.09.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të gjykatës europiane për të drejtat e njeriut, datë 14.06.2022, për çështjen ‘Balkasi dhe të tjerë kundër Shqipërisë’.
  - 46 milionë lekë me VKM nr. 740, datë 23.11.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MFE, për rimbursimin e masave administrative të falura, të paguara, sipas ligjit 112/2022, për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.

- 396.6 milionë lekë me VKM nr. 753, datë 1.12.2022 "Për kompesimin e të ardhurave të personave që përfitojnë pension invaliditeti, për vitin 2022".
- 2.7 milionë lekë me VKM nr. 760, datë 12.12.2022 "Për ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Europiane për të drejtat e Njeriut, për çështjen X kundër Shqipërisë dt 31.05.2022, për kërkesat nr. 73548/17 dhe 45521/19".
- 2 milionë lekë me VKM nr. 819, datë 19.12.2022 "Për Ekzekutimin e VGJEDNJ , dt 21.01.2020, për çështjen "Strazimiri kundër Shqipërisë".
- 1.6 milionë lekë me VKM nr. 860, datë 27.12.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ, për çështjen 'Prizreni kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr. 29309/16).
- ✓ 700 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Kulturës nëpërmjet VKM-së, nr. 287, datë 10.05.2022 "Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit "Tirana Youth European Capital, 2022".
- ✓ 399 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me VKM nr. 745, datë 23.11.2022 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit".
- ✓ 190 milionë lekë janë akorduar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet VKM-së nr. 100, datë 9.02.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për komisionin qendror të zgjedhjeve, për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 6 mars 2022".
- ✓ 160 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet VKM-së nr. 330, datë 18.05.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS".
- ✓ 116.7 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Punëve të Jashtme nëpërmjet VKM-së nr. 406, datë 10.06.2022 "Për dhënie ndihme humanitare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e qeverisë së Ukrainës".
- ✓ 65 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me VKM-në nr. 248, datë 20.04.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për ministrinë e turizmit dhe mjedisit nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2022, për pagesën e studios për çështjen e anullimit të vendimit të arbitrazhit icsid case nr. Arb/14/26".
- ✓ 69.7 milionë lekë janë akorduar për "Institucionet e tjera Qeveritare " dhe konkretisht:
  - 19.7 milionë lekë janë akorduar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", me VKM nr. 32, datë 19.01.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe INSTAT-in, për financimin e programit të Këshillimit Kombëtar".
  - 50 milionë lekë janë akorduar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare me VKM nr. 742, datë 23.11.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për DSHQ, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të "Samitit BE-BP", të datës 6 Dhjetor 2022".
- ✓ 7.2 milion lekë akorduar për Ministrinë e Brendshme me VKM nr. 745, datë 23.11.2022 "Për dhënie kontributi financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e Fondit

Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit (GCERF) “Për dhënie kontributi financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e Fondit Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit (GCERF)”

- ✓ 5.3 milionë lekë janë akorduar për INSTAT-in me VKM-në nr. 32, datë 19.01.2022 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe INSTAT-in, për financimin e programit të Këshillimit Kombëtar”.

***Mbështetur në sa më sipër rezulton se, në datën 31.12.2022, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, është 11.1 milionë lekë.***

- **Fondi “Për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën”, i planifikuar për 7.8 miliardë lekësh me AN nr. 19, datë 29.12.2022, është përdorur në masën 7.74 miliardë lekësh sipas VKM-ve si më poshtë:**
  1. Me VKM nr. 897, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve për zbutjen e impaktit të krizës”, i është akorduar MFE-së fondi prej 5 605 milionë lekë.
  2. Me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për Zbutjen e Impaktit të Krizës”, i është akorduar fondi prej 970.4 milionë lekë.
  3. Me VKM nr. 899, datë 29.12.2022 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të vecanta për zbutjen e impaktit të krizës”, i është akorduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale fondi prej 1 160.4 milionë lekë.

***Mbështetur në sa më sipër rezulton se, në datën 31.12.2022, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën është 63.8 milionë lekë.***

## **II. Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit**

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit në masën 4.8 miliard lekësh, deri me datë 31.12.2022, nuk është përdorur.